



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 898/5 prot

Datë 21.06.2021

V E N D I M
Nr. 297/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit Nr. REF-95880-05-19-2021 me objekt *“Blerje materiale për mirëmbajtjen e Ndriçimit Rrugor në Qytetin e Lezhës”*, me fond limit 19,265,555 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 11.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Mag Utilities” SHPK
Adresa: Blloku rezidencial “Kodra e Diellit”, A 0/1 Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Bashkia Lezhë
Adresa: L. “Skënderbeg, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.05.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me Nr. REF-95880-05-19-2021 me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e Ndriçimit Rrugor në Qytetin e Lezhës”, me fond limit 19,265,555 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 11.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

II.2. Në datën 26.05.2021 operatori ekonomik “Mag Utilities” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 10233/2 prot., datë 31.05.2021, protokolluar me tonën me nr. 898/2 prot., datë 01.06.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “Mag Utilities” SHPK dhe me shkresën nr. 9440/13 prot., datë 31.05.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës (pikën 3 dhe pikën 4 të ankesës lidhur me specifikimet teknike). Konkretisht ankimesi në pikat 3 dhe 4 të ankesës lidhur me specifikimet teknike ka ankimuar mospërputhjen e specifikimeve teknike, si dhe parameetrat e përcaktuara për produktin “Koka ndriçuesi LED 50 wat”. Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se pikat e mësipërme të ankesës janë pranuar si vijon:

“[...]Sa më sipër, sa i përket pretendimit të ankuesit në lidhje me specifikimet teknike për produktin “Kokë ndriçuesi Led 50 V”, KSHA për verifikimin e këtij pretendimi, mori në administrim dokumentacionin e Drejtorisë përkatëse dhe dokumentacionin e njësisë së hartimit të specifikimeve teknike nga ku rezulton se është bërë një gabim njerëzor dhe ka një mospërputhje të kërkesës për blerje, me specifikimet teknike për këtë produkt.

Për rrjedhojë pretendimi i ankuesit qëndron dhe për këtë NJ. Përgjegjëse të hartojë një shtojcë duke reflektuar ndryshimet përkatëse [...]

II.6. Gjithashtu konstatohet se autoriteti kontraktor ka ngarkuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, me anë të së cilës ka bërë ndryshimet si vijon:

“[...]Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit

ISHTE

2.3.7 Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- *Nga 1 (një) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:*

<i>Automat monofaze 32 A</i>
<i>Koka ndriçuesi Led 50V</i>
<i>Lëshues magnetik 80A</i>
<i>Lëshues magnetik 100A</i>
<i>Salvavita 63A 3 Fazor</i>
<i>Salvavita 100A 3 Fazor</i>
<i>Finter rrugor 16A (4hyrje)</i>

- *Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Drejtorisë së shërbimeve Publike, së Bashkisë Lezhe me adresë: Rruga Vëllezrit Coku, Ish SMT, Lezhë.*
- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementet: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.*
- *Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.*

BEHET

2.3.7 Ditën dhe oren e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- *Nga 1 (një) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:*

<i>Automat monofaze 32 A</i>
<i>Koka ndriçuesi Led</i>
<i>Lëshues magnetik 80A</i>
<i>Lëshues magnetik 100A</i>
<i>Salvavita 63A 3 Fazor</i>

Salvavita 100A 3 Fazor

Finter rrugor 16A (4hyrje)

- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Drejtorisë së shërbimeve Publike, së Bashkisë Lezhë me adresë: Rruga Vëllezrit Coku, Ish SMT, Lezhë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

ISHTE:

**SASIA DHE GRAFIKU I LEVRIMIT
PREVENTIVI**

Nr	Emërtimi i mallit	NJESIA	SASIA
1	Puseta kontrolli (30x30x30)	copë	335
2	Tub plastik Ø 200mm	ml	335
3	Shina për kaseta metalike 40cm	ml	30
4	Automat monofaze 32 A	copë	5
5	Koka ndriçusi Led 50V	copë	335
6	Lëshues magnetik 80A	copë	15
7	Lëshues magnetik 100A	copë	5
8	Salvavita 63A 3 Fazor	copë	13
9	Salvavita 100A 3 Fazor	copë	2
10	Finter rrugor 16A(4hyrje)	copë	30
11	Bulona për elektroda tokëzimi	copë	1000
12	Kabull Φ(3x2.5)	ml	3500
13	Kabull Φ(4x10)	ml	7100
14	Kabull Φ(4x4)	ml	1000
15	Bazament siguresë	copë	335
16	Tel Togëzimi 1x6	copë	149
17	Shtylla metalike për ndriçim H=7m, d=160mm	copë	200
18	Shtylla metalike për ndriçim H=9m, kod PAICC-3	copë	135
19	Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10	copë	330
20	Krah shtylle metalike dyshe KRH-MSI 1500/1500/11	copë	5
21	Kapak shtyllash	copë	335
22	Klema Φ16mm	copë	500
23	Klema Φ6mm	copë	500
24	Klema Φ10mm	copë	500
25	Sigures shtyllash	copë	333
26	Tub korrogat Φ50mm	ml	9000
27	Elektroda tokëzimi, profil zingato e bakerizuar,L=2m + bolona	copë	335
28	Tiranta (kapse për kabull)	copë	50

29	Kasetë metalike (30x30)	copë	10
30	Kasetë metalike (50x70)	cope	8

BEHET:

**SASIA DHE GRAFIKU I LEVRIMIT
PREVENTIVI**

Nr	Emërtimi i mallit	NJESIA	SASIA
1	Puseta kontrolli (30x30x30)	copë	335
2	Tub plastik Ø 200mm	ml	335
3	Shina për kasete metalike 40cm	ml	30
4	Automat monofaze 32 A	copë	5
5	Koka ndriçuesi Led	copë	335
6	Lëshues magnetik 80A	copë	15
7	Lëshues magnetik 100A	copë	5
8	Salvavita 63A 3 Fazor	copë	13
9	Salvavita 100A 3 Fazor	copë	2
10	Finter rrugor 16A(4hrje)	copë	30
11	Bulona per elektroda tokëzimi	copë	1000
12	Kabull Φ(3x2.5)	ml	3500
13	Kabull Φ(4x10)	ml	7100
14	Kabull Φ(4x4)	ml	1000
15	Bazament sigurese	copë	335
16	Tel Togezi 1x6	copë	149
17	Shtylla metalike për ndriçim H=7m, d=160mm	copë	200
18	Shtylla metalike për ndriçim H=9m, kod PAICC-3	copë	135
19	Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10	copë	330
20	Krah shtylle metalike dyshe KRH-MSI 1500/1500/11	copë	5
21	Kapak shtyllash	copë	335
22	Klema Φ16mm	copë	500
23	Klema Φ6mm	copë	500
24	Klema Φ10mm	copë	500
25	Sigures shtyllash	copë	333
26	Tub korrogat Φ50mm	ml	9000
27	Elektroda tokëzimi, profil zingato e bakerizuar, L=2m + bolona	copë	335
28	Tiranta (kapse për kabull)	copë	50
29	Kasetë metalike (30x30)	copë	10
30	Kasetë metalike (50x70)	cope	8

ISHTE:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i mallit</i>	<i>Specifikimet teknike</i>
1	<i>Puseta kontrolli (30x30x30)</i>	<i>Materiali : Polipropilen; Përmasat:30x30cm;Lartësia:30cm.</i>
2	<i>Tub plastik Ø 200mm</i>	<i>Diametri (në hyrje) : 200mm;materiali:plastik;diametri në dalje:200mm;gjatësia:3m;forma: I drejtë.</i>
3	<i>Shina për automate</i>	<i>Gjatësia : 2m; gjerësia:3,5cm; thellësia:7,5mm; seksioni:1mm²; material:çelik.</i>
4	<i>Automat monofaze 32 A</i>	<i>Rryma nominale 32A Tensioni i punës 220V; Frekuenca 50/60Hz; Rryma e lidhjes se shkurter 10 kA(6-63A), 8 kA (80-100A); Numri i poleve 1, 2; Shkalla e mbrojtjes IP20; Numri i çkyçjeve elektrike jo me pak se 8,000 here; Numri i çkyçjeve mekanike jo me pak se 20,000 here; Seksioni maksimal i lidhjes 1-35 mm²; Kurba e çkyçjes B ose C; Tensioni i izolimit 500V; Tensioni impulsiv i qendrueshmerise 4kV; Temperatura e punes -5°C ~+40 °C</i>
5	<i>Koka ndriçuesi LED 50 ëat</i>	<i>Ndriçuesi te kete pllake fosfori dhe pa efekte verbuese; Draver LED; 50 ëat sipas standarteve EMC ose ekuivalent; Koef I ngarkeses: COS.0,95. Ndriçuesi te jete I paisur me mbrojtje nga shkarkimet elektrike, atmosferike dhe mbinxehja. Mbrojtje nga lidhjet e shkurtra, 'Fluks i ndriçimit: min 12,500LM.</i>
6	<i>Leshues magnetik 80A</i>	<i>Intensiteti 80A, Tensioni 380 VOLT</i>
7	<i>Leshues magnetik 100A</i>	<i>Intensiteti 100A, Tensioni 380 VOLT</i>
8	<i>Salvavita 63A 3 Fazor</i>	<i>Tensioni 380 V, Rryma 63 A</i>
9	<i>Salvavita 100A 3 Fazor</i>	<i>Tensioni 380 V, Rryma 100A</i>
10	<i>Finter rrugor 16A(4hyrje)</i>	<i>Rele me dy gjendje Finder , I=16 A; U=250 V,4Polar.</i>
11	<i>Bulona per elektroda tokezimi</i>	<i>Bulona M8.</i>
12	<i>Kabull Φ(4x10)</i>	<i>Kabull 4x10mm² Cu .PVC 0.4-1 kV,fleksibel CAV FG7OR/3 4G 2.5: Me tension maksimal 1200 V, Temperature maksimale pune 90 °C, Temperatura maksimale per LSH 220 °C, Temperature minimale pune - 15 °C. Trashesia e izolacionit 0.7 mm, Me diameter te jashtem 17.8 mm, Pesha 611 kg/km, Rezistenca elektrike ne 20 °C 1.91 (Ohm/km), Mer ryme maksimale te lejuar ne ambient te hapur 60 A per temperature 30 °C.</i>

13	Kabull $\Phi(3 \times 2,5)$	Kabull $3 \times 2,5 \text{ mm}^2$ Cu .PVC 0.4-1 kV, fleksibel CAV FROR/3 4G 2.5: Me tension maksimale 825 V, Temperatur maksimale pune 70°C , Temperatura maksimale per LSH 160°C , Temperatur minimale pune -10°C . Trashesia e izolacionit 0.8 mm, Me diameter te jashtem 10.35 mm, Pesha 165.7 kg/km, Rezistenca elektrike ne 20°C 7.98 (Ohm/km), Mer ryme maksimale te lejuar ne ambient te hapur 20 A per temperature 30°C
14	Kabull $\Phi(4 \times 4)$	Percjellesi Baker I zhveshur ne perputhje me CEI EN 60228 Klasi 5 Izolacioni dhe shtresat XLPE , Shtresat jane me ngjyre sipas HD 308 S2 Veshja e jashtme Ngjyra blu RAL 5015 Tensioni operimit 0,6/1kV Tensioni testuar 4000V Rezistenca e izolacionit $> 200 \text{ M}\Omega \text{ km}$ Temperatura maksimale ne uje $+40^\circ\text{C}$ Instalimi $-25/50^\circ\text{C}$ Temperatura maksimale ne percjelles $+90^\circ\text{C}$ Temperatura e aplikimit $-40/80^\circ\text{C}$ Rrezja minimale e perthyerjes 5 x diametrit te jashtem. Ndotja e gazrave halogjene $< 0,5\%$ IEC 60754 , CEI EN 50267-2, Diametri nominal 13.6 mm, Pesha bakrit 153.6 kg/km, Pesha kabullit 272kg/km
15	Bazament sigures	Rryma nominale 25/63A; 4Polar
16	Tel Togezi 1×6	Tel (percjelles elektrik) $1 \times 6 \text{ mm}^2$ Materiali Cu .PVC 0.4-1 kV, fleksibel
17	Shtylla metalike per ndriçim $H=7\text{m}$, $d=160\text{mm}$	Materiali: xingato; lartesia $H=7\text{m}$; diametri 160mm.
18	Shtylla metalike per ndriçim $H=9\text{m}$, kod PAICC-3	Materiali: xingato; lartesia $H=9\text{m}$.
19	Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10	Materiali : xingati, I kalandruar. sipas standarteve.
20	Krah shtylle metalike dyshe KRH-MSI 1500/1500/11	Materiali : xingati, I kalandruar. sipas standarteve.
21	Kapak shtyllash	Materiali: çelik; me gomina izoluese.
22	Klema $\Phi 16\text{mm}$	Materiali plastik/metalik; seksioni 16mm^2
23	Klema $\Phi 6\text{mm}$	Materiali plastik/metalik; seksioni 6mm^2
24	Klema $\Phi 10\text{mm}$	Materiali plastik/metalik; seksioni 10mm^2
25	Sigures shtyllash	Gjatësia : 20mm; gjatesia 20mm; gjerësia: 5mm; materiali: porcelan/metal; tensioni: 230-400V;
26	Tub korrogat $\Phi 50\text{mm}$	Tub I brinjezuar me $\Phi 50\text{mm}$; materiali HDPE; gjatesi: 50ml; ngjyra e zeze.
27	Elektrode tokezimi $50 \times 50 \times 3\text{mm}$, 1.5m	Elektrode tokezimi $50 \times 50 \times 3\text{mm}$, 1.5m; gjatesia: 150; gjerësia: 5; seksioni (mm^2); materiali : çelik I galvanizuar.
28	Tiranta (kapse per	Materiali poliamide, standarti IP68, ngjyra gri.

	<i>kabull)</i>	
29	<i>Kasete metalike (30x30 - 50x70)</i>	<i>Materiali:çelik; gjeresia 30cm;gjatesia 30cm thellësia:11cm;</i>

BEHET:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i mallit</i>	<i>Specifikimet teknike</i>
1	<i>Puseta kontrolli (30x30x30)</i>	<i>Materiali : Polipropilen; Permasat:30x30cm;Lartësia:30cm.</i>
2	<i>Tub plastik Ø 200mm</i>	<i>Diametri (ne hyrje) : 200mm;materiali:plastik;diametri ne dalje:200mm;gjatesia:3m;forma: I drejte.</i>
3	<i>Shina per automate</i>	<i>Gjatësia : 2m; gjerësia:3,5cm; thellësia:7,5mm; seksioni:1mm²; material:çelik.</i>
4	<i>Automat monofaze 32 A</i>	<i>Rryma nominale 32A Tensioni i punës 220V; Frekuenca 50/60Hz; Rryma e lidhjes se shkurter 10 kA(6-63A), 8 kA (80-100A); Numri i poleve 1, 2; Shkalla e mbrojtjes IP20; Numri i çkyçjeve elektrike jo me pak se 8,000 here; Numri i çkyçjeve mekanike jo me pak se 20,000 here; Seksioni maksimal i lidhjes 1-35 mm²; Kurba e çkyçjes B ose C; Tensioni i izolimit 500V; Tensioni impulsiv i qendrueshmerise 4kV; Temperatura e punes -5°C ~+40 °C</i>
5	<i>Koka ndriçuesi LED</i>	<i>Koke Ndricuesi LED/Ekuivalent për ndricim rrugorë, Driver LED, 100 ëat sipas standardeve EMC ose ekuivalent. Limiti i luhatjes së tensionit 100-240 V Koeficienti i ngarkesës COS > 0.95 Fluksi i ndricimit të llampës Min 8,000 LM Niveli i mbrojtjes Ndricuesi Min IP 65 Temperatura e ngjyrës së ndricimit Min 6400 K Temperatura e Përdorimit Min – 20 °C deri në + 40 °C Izolacioni Galvanik- PO Ndricuesi të jetë i paisur me mbrojtje nga shkarkimet elektrike, atmosferike (rrufeja) dhe mbinxehja-PO</i>
6	<i>Leshues magnetik 80A</i>	<i>Intensiteti 80A, Tensioni 380 VOLT</i>
7	<i>Leshues magnetik 100A</i>	<i>Intensiteti 100A, Tensioni 380 VOLT</i>
8	<i>Salvavita 63A 3 Fazor</i>	<i>Tensioni 380 V, Rryma 63 A</i>
9	<i>Salvavita 100A 3 Fazor</i>	<i>Tensioni 380 V, Rryma 100A</i>

10	<i>Finter rrugor 16A(4hyrje)</i>	<i>Rele me dy gjendje Finder , I=16 A; U=250 V,4Polar.</i>
11	<i>Bulona per elektroda tokezimi</i>	<i>Bulona M8.</i>
12	<i>Kabull $\Phi(4x10)$</i>	<i>Kabull 4x10mm² Cu .PVC 0.4-1 kV,fleksibel CAV FG7OR/3 4G 2.5: Me tension maksimal 1200 V, Temperature maksimale pune 90^oC, Temperatura maksimale per LSH 220^oC, Temperature minimale pune - 15^oC. Trashesia e izolacionit 0.7 mm, Me diameter te jashtem 17.8 mm, Pesha 611 kg/km, Rezistenca elektrike ne 20^oC 1.91 (Ohm/km), Mer ryme maksimale te lejuar ne ambient te hapur 60 A per temperature 30^oC.</i>
13	<i>Kabull $\Phi(3x2,5)$</i>	<i>Kabull 3x2,5mm² Cu .PVC 0.4-1 kV,fleksibel CAV FROR/3 4G 2.5: Me tension maksimal 825 V, Temperaturemaksimale pune 70^oC, Temperatura maksimale per LSH 160^oC, Temperature minimale pune - 10^oC. Trashesia e izolacionit 0.8 mm, Me diameter te jashtem 10.35 mm, Pesha 165.7 kg/km, Rezistenca elektrike ne 20^oC 7.98 (Ohm/km), Mer ryme maksimale te lejuar ne ambient te hapur 20 A per temperature 30^oC</i>
14	<i>Kabull $\Phi(4x4)$</i>	<i>Percjellesi Baker I zhveshur ne perputhje me CEI EN 60228 Klasi 5 Izolacioni dhe shtresat XLPE , Shtresat jane me ngjyre sipas HD 308 S2 Veshja e jashtme Ngjyra blu RAL 5015 Tensioni operimit 0,6/1kV Tensioni testuar 4000V Rezistenca e izolacionit > 200 MΩ km Temperatura maksimale ne uje +40^oC Instalimi -25/50 ^oC Temperatura maksimale ne percjelles + 90^oC Temperatura e aplikimit -40/80^oC Rrezja minimale e perthyerjes 5 x diametrit te jashtem Ndotja e gazrave halogjene < 0,5% IEC 60754 , CEi EN 50267-2, Diametri nominal 13.6 mm, Pesha bakrit 153.6 kg/km, Pesha kabullit 272kg/km</i>
15	<i>Bazament siguresse</i>	<i>Rryma nominale 25/63A;4Polar</i>
16	<i>Tel Togeziimi 1x6</i>	<i>Tel (percjelles elektrik)1x6 mm² Materiali Cu .PVC 0.4-1 kV,fleksibel</i>
17	<i>Shtylla metalike per ndriçim H=7m, d=160mm</i>	<i>Materiali: xingato; lartesia H=7m; diametri 160mm.</i>
18	<i>Shtylla metalike per ndriçim H=9m, kod PAICC-3</i>	<i>Materiali: xingato; lartesia H=9m.</i>
19	<i>Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10</i>	<i>Materiali : xingati,I kalandruar.sipas standarteve.</i>
20	<i>Krah shtylle metalike dyshe KRH-MSI 1500/1500/11</i>	<i>Materiali : xingati,I kalandruar.sipas standarteve.</i>
21	<i>Kapak shtyllash</i>	<i>Materiali:çelik; me gomina izoluese.</i>

22	<i>Klema Φ16mm</i>	<i>Materiali plastik/metalik;seksioni 16mm²</i>
23	<i>Klema Φ6mm</i>	<i>Materiali plastik/metalik;seksioni 6mm²</i>
24	<i>Klema Φ10mm</i>	<i>Materiali plastik/metalik;seksioni 10mm²</i>
25	<i>Sigures shtyllash</i>	<i>Gjatësia : 20mm; gjatesia 20mm;gjeresia:5mm; materiali: porcelan/metal;tensioni:230-400V;</i>
26	<i>Tub korrogat Φ50mm</i>	<i>Tub I brinjezuar me Ø50mm;materiali HDPE; gjatesi:50ml;ngjyra e zeze.</i>
27	<i>Elektrode tokezimi 50x50x3mm, 1.5m</i>	<i>Elektrode tokezimi 50x50x3mm, 1.5m; gjatesia:150;gjeresia:5;seksioni(mm²);materiali :çelik I galvanizuar.</i>
28	<i>Tiranta (kapse per kabull)</i>	<i>Materiali poliamide,standarti IP68,ngjyra gri.</i>
29	<i>Kasete metalike (30x30 - 50x70)</i>	<i>Materiali:çelik; gjeresia 30cm;gjatesia 30cm thellesia:11cm;</i>

[...]"

II.7. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 256/2021, datë 03.06.2021 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me Nr. REF-95880-05-19-2021 me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e Ndrëçimit Rrugor në Qytetin e Lezhës”, me fond limit 19,265,555 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 11.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Sa më sipër, gjykojmë se kërkesa për disponueshmërinë e Kamion vinç kapacitet mbajtës min 7 ton është një kërkesë e ekzagjeruar, e cila bie ndesh me parimet e mosdiskriminimit, duke dëmtuar njëkohësisht edhe garën për këtë procedurë prokurimi. Pasi morëm në shqyrtim dokumentacionin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatojmë se autoriteti juaj kontraktor ka kategorizuar kontratën e mësipërme në kategorinë kontratë furnizimi/mallra, e cila përfshin vetëm furnizimin e autoritetit kontraktor me mallrat e përcaktuara në shtojcën 12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, dhe jo vendosjen e tyre. Për këtë arsye vlerësojmë se kërkesa për disponueshmërinë e Kamion vinç me kapacitet mbajtës min 7 ton, është e ekzagjeruar dhe e panevojshme, sepse për aq kohë sa nuk kemi të parashikuar vendosjen e mallrave gjykojmë se është e panevojshme dhe nuk i shërben realizimit me sukses të

kontratës disponueshmëria e vinçit. Sa më sipër gjykojmë se do të ishte e mjaftueshme kërkesa për disponimin e një mjeti tip kamioncinë për transportin e mallrave, pa qenë e nevojshme disponueshmëria gjithashtu edhe e Kamionit vinç. Sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e mëposhtme në pronësi dhe ose/ me qira për transportin e mallrave deri në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Kamion vinç kapacitet mbajtës min 7 ton	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamioncinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton	Copë 1	Në pronësi ose me qira

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës të DST duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, taksa, pronësia dhe foto), si dhe certifikatë për transport mallrash në përputhje me ligjin nr. 8308 datë 18.3.1998 “ Për transportet rrugore”, i ndryshuar

b- Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira të paraqiten si më poshtë:

- Kontratë noteriale qiraje me afat të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e kontratës dhe / ose;
- Kontratë noteriale qiraje të jetë e shoqëruar për secilin nga automjetet e marra me qira me leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, taksa, pronësinë dhe foto).”

III.1.2. Në shtojcën 12, pika “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“

Nr	Emërtimi i mallit	NJESIA	SASIA
1	Puseta kontrolli (30x30x30)	copë	335
2	Tub plastik Ø 200mm	ml	335
3	Shina për kaseta metalike 40cm	ml	30
4	Automat monofaze 32 A	copë	5
5	Koka ndriçusi Led 50V	copë	335
6	Lëshues magnetik 80A	copë	15
7	Lëshues magnetik 100A	copë	5
8	Salvavita 63A 3 Fazor	copë	13
9	Salvavita 100A 3 Fazor	copë	2
10	Finter rrugor 16A(4hrje)	copë	30

11	Bulona për elektroda tokëzimi	copë	100 0
12	Kabull $\Phi(3 \times 2.5)$	ml	350 0
13	Kabull $\Phi(4 \times 10)$	ml	710 0
14	Kabull $\Phi(4 \times 4)$	ml	100 0
15	Bazament siguresë	copë	335
16	Tel Togëzimi 1x6	copë	149
17	Shtylla metalike për ndriçim $H=7m$, $d=160mm$	copë	200
18	Shtylla metalike për ndriçim $H=9m$, kod PAICC-3	copë	135
19	Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10	copë	330
20	Krah shtylle metalike dyshe KRH-MSI 1500/1500/11	copë	5
21	Kapak shtyllash	copë	335
22	Klema $\Phi 16mm$	copë	500
23	Klema $\Phi 6mm$	copë	500
24	Klema $\Phi 10mm$	copë	500
25	Sigures shtyllash	copë	333
26	Tub korrogat $\Phi 50mm$	ml	900 0
27	Elektroda tokëzimi, profil zingato e bakërizuar, $L=2m$ + bolona	copë	335
28	Tiranta (kapse për kabull)	copë	50
29	Kasete metalike (30x30)	copë	10
30	Kasete metalike (50x70)	copë	8

”

III.1.3. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit me shkresën nr. 9440/13 prot., datë 31.05.2021, ka justifikuar mospranimin e pretendimit të mësipërm të operatorit ekonomik ankimes “Mag Utilities” SHPK si më poshtë:

“[...]Sa më sipër në lidhje mbi disponueshmërinë e mjeteve të kërkuara në DST, KSHA gjykon se ky kriter është në proporcion me natyrën e shërbimit, volumin e tyre dhe vlerën në tërësi të kontratës objekt prokurimi, pasi referuar zërave te preventivit, nga AK kërkohet furnizimi me:

<i>Tub plastik Ø 200mm</i>	<i>ml</i>	<i>335</i>
<i>Koka ndriçuesi Led 50V</i>	<i>copë</i>	<i>335</i>
<i>Kabull Φ(3x2.5)</i>	<i>ml</i>	<i>3500</i>
<i>Kabull Φ(4x10)</i>	<i>ml</i>	<i>7100</i>
<i>Kabull Φ(4x4)</i>	<i>ml</i>	<i>1000</i>
<i>Shtylla metalike për ndriçim H=7m, d=160mm</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
<i>Shtylla metalike për ndriçim H=9m, kod PAICC-3</i>	<i>copë</i>	<i>135</i>
<i>Krah shtyllë metalike KRH-MSI 1500/1500/10</i>	<i>copë</i>	<i>330</i>
<i>Krah shtyllë metalike dyshe KRH-MSI 1500/1500/11</i>	<i>copë</i>	<i>5</i>
<i>Tub korrogat Φ50mm</i>	<i>ml</i>	<i>9000</i>

Nisur nga sasia e lartë, pesha e konsiderueshme materialeve të mësipërme si dhe pamundësia e ngarkim/shkarkimit të këtyre materialeve me anë të forcës së krahut, KSHA gjykon se për kryerjen e furnizimit dhe realizimit me sukses të kësaj kontrate është e nevojshme disponimi i mjeteve të kërkuara. Gjithashtu KSHA, vlerëson se në vendosjen e kriterit për disponueshmërinë e mjeteve është mbajtur në konsideratë edhe fakti se në magazinën e Bashkisë Lezhë nuk ka të instaluar vinç për shkarkimin e këtyre mallrave. Mungesa e një vinçi për shkarkim mallrash, sasisë së madhe si dhe peshës së mallrave të parashikuar në preventiv, detyron AK-në të kërkojë që furnizuesi të disponojë minimalisht një Kamion i pajisur me vinç me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton, për mallrat me sasi dhe peshë të madhe si dhe një Kamionçinë me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton për mallrat me peshë relativisht më të vogël të cilat mund të shkarkohen me forcën e krahut. [...]”

III.1.5. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (mjetet e transportit), në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës objekt prokurimi. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e një kamioni vinç me kapacitet mbajtës jo më pak se 7 ton, referuar objektit dhe volumit të kontratës objekt prokurimi, sasive dhe karakteristikave të disa prej mallrave të parashikuara në preventiv, Komisioni gjykon se kjo kërkesë nuk është e ekzagjeruar dhe kufizuese, si dhe është e justifikuar nga autoriteti kontraktor, pasi disa prej mallrave objekt prokurimi, kërkojnë kapacitete

transportuese të konsiderueshme, si dhe kapacitete të posaçme shkarkimi. Akoma më tej, Komisioni vëren se autoriteti kontraktor ka përcaktuar dy mënyra disponimi/posedimi të këtyre mjeteve, duke iu lënë mundësinë operatorëve ekonomik të interesuar të përmbushin këtë kriter edhe nëpërmjet kontratës së qirasë. Në këto kushte, Komisioni gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor është e justifikuar dhe në përputhje me volumin e kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin:

“Në rastin konkret, referuar kriterëve të veçanta për kualifikim konstatohet se ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të dorëzojë katalog të prodhuesit për mallrat objekt prokurimi, duke mos parashikuar në këtë mënyrë që operatorët ekonomikë të përmbushin këtë kriter nëpërmjet dorëzimit të fragmenteve të katalogëve ose të skedave teknike.

Në rastin konkret, vlerësojmë se qëllimi i autoriteti kontraktor në parashikimin e këtij kriteri është që të garantohet për përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatorët ekonomikë për mallrat objekt prokurimi, qëllim i cili në gjykimin tonë mund të realizohet edhe nëpërmjet dorëzimit nga ana e operatorëve ekonomikë të fragmenteve të katalogëve ose të skedave teknike, nëpërmjet të cilave gjithashtu është e mundur vërtetimi i përmbushjes ose jo të specifikimeve teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, vlerësojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin vetëm të katalogëve për mallrat objekt prokurimi, duke mos lënë të hapur mundësinë e dorëzimit të fragmenteve të katalogëve apo të skedave teknike është një kërkesë diskriminuese dhe e ekzagjeruar e cila nuk i shërben përmbushjes së qëllimit kryesor të ligjit “Për Prokurimin Publik” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, madje përkundrazi bën ndesh me frymën e ligjit duke ulur konkurrencën dhe efijencën e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Sa më sipër, kërkojmë që nga autoriteti kontraktor të jepet mundësia e përmbushjes së këtij kriteri nëpërmjet dorëzimit të Katalogëve/apo fragmente të katalogëve ose të skedave teknike për mallrat objekt prokurimi. Sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.6 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog të prodhuesit për mallrat objekt prokurimi, ku të pasqyrohen të gjithë specifikimet teknike të produktit.”

III.2.2. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie””

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentete e tenderit. Në rastin konkret, në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të paraqesin vetëm katalog për të vërtetuar se mallrat objekt prokurimi plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike, Komisioni gjykon se është një kërkesë kufizuese, pasi identifikimi i specifikimeve teknike të mallrave objekt-prokurimi, si dhe i parametrave teknike të tyre, jo domosdoshmërisht mund të bëhet vetëm nëpërmjet katalogëve, por mund të bëhet edhe nëpërmjet dokumenteve të tjera të cilat pasqyrojnë në mënyrë autentike specifikimet teknike dhe parametrat e produkteve të ofruara. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke mos e kufizuar dokumentacionin që duhet paraqitur për të vërtetuar përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve që ofrohen nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mag Utilities” SHPK për procedurën e prokurimit Nr. REF-95880-05-19-2021 me objekt “*Blerje materiale për mirëmbajtjen e Ndriçimit Rrugor në Qytetin e Lezhës*”, me fond limit 19,265,555 lekë pa

TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 11.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mag Utilities” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

